



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Nr. I faq. 03
Broj stranice 03
Nr. pages 03

Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 03-03/575/18
Data Datum Date 02-03-2018

PRISHTINE

DATË/A:	01.03.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-565/18
PËR/ZA/TO:	z. Abaz FONIQI, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Klinës
CC:	z. Zenun ELEZAJ, Kryetar i Komunës së Klinës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative "

I nderuar z. FONIQI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative ", me numër të prokurimi: 634-18-813-121, me nr. të brendshëm: 634-18-006-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative** ", me numër të prokurimi: 634-18-813-121, me nr. të brendshëm: 634-18-006-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 28.02.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-565/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative*", me numër të prokurimi: *634-18-813-121*, me nr. të brendshëm: *634-18-006-121*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës.

Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë aktivitet të prokurimit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, ka konstatuar faktet si në vijim: Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar në Platformën *E-Prokurimi* të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me datë 20.02.2018, ku për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë me disa Operator të llojit furnizim me vlerë të mesme.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma *E-Prokurimi*, ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës, Agjencia ka vërejtur se Autoriteti Kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar: **1.** Çmimin të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0,70, si dhe nën kriteri **2. Afati i furnizimeve** me koeficient 0,20 dhe **3. Garancioni** – mirëmbajtja pas shitjes me koeficient 0,10.

Në lidhje me nën kriteret 2 dhe 3, Agjencia konstaton se të njëjtat kriterë nuk mund të përdoren si kriterë për dhënie të kontratës dhe si rrjedhojë bien ndesh me nenin 52 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Mirëmbajtja apo shërbimi pas shitjes mund të caktohen si nën kriterë për dhënie të kontratës, ndërsa afati i furnizimeve dhe garancioni si kushte mund të caktohen tek kushtet e veçanta të kontratës.

Agjencia konsideron se Autoriteti Kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet që kriter për dhënie të kontratës të jet kriteri Tenderi ekonomikisht më i favorshëm të caktoj nën kriterë të qarta, precize, matshme dhe të cilat janë kriterë të ligjshme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 28 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me Respekt !

OSG * OASG